



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:080583

Datë: 03.01.2025

Numri i dokumentit: 06677568

P.nr.54/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci me pjesëmarrjen e Bashkëpuntores Profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurve, P E nga fshati G K.K, Sh M nga fshati B K.K, dhe J I nga fshati D K.K, të akuzuar për shkak se, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale;Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nënpar.1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP//II.nr.2761/2022 e dt.31.03.2023 në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt.26.11.2024, në prani të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë dhe të pandehurve të lartë cekur si dhe palës së dëmtuar A I pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt.30.11.2024, në të njëjtën ditë shpalli aktgjykimin ndërsa me datën:03.01.2025 e përpiloi këtë.

A K T G J Y K I M

Ndaj:Të pandehurve:

1.J I i lindur me dt. në fshatin L K.M, tani me banim në fshatin D K.K i biri H dhe nënës Z, e vajzërisë G, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, baba i fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Kosovës, mbrohet në liri.

2. P E i lindur me dt. në fshatin G K.K, ku dhe tani banon i biri i Gj E dhe nënës V, e vajzërisë M, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Kosovës, mbrohet në liri.

3. Sh M i lindur me dt. në fshatin B K.K, ku dhe tani banon, i biri i F M dhe nënës S, e vajzërisë F, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion , i martuar, baba fëmijve, i gjendjes së mesme ekonomike, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

1.Me dt.23.12.2022 rreth orës 21:05 në sheshin „NT,, në pikërisht tek parkingu i ëmbëltores „D,, personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit dhe atë këtu të dëmtuarit A I në atë mënyrë që në kohën dhe vendin e lartëcekur, përderisa këtu i dëmtuari sapo kishte dal nga ëmbëltoja duke shkuar në drejtim të veturës së tij, në parking fillimisht i ofrohet i pandehuri J I, i cili e godet me shqelm derën e veturës së të dëmtuarit e më pas fillon ta godas me grushta nëpër trup ku i bashkangjitet edhe i pandehuri P E i cili e godet me shuplakë në fytyrë e më pas edhe i pandehuri Sh M duke e goditur vazhdimisht me grushta në trup me çka të njëjtit i shkaktojnë kontuzion në kokë, në artikulationin radio-karpat të dorës së djathtë dhe në artikulationin talo –krural të këmbës së djathtë pastaj pastaj gërvishje në vithen e djathtë në komblik, hematomë në qafë si dhe enjëte mbi syrin e majtë, të shkaktuar me një mjet i fortë dhe i rëndë mbretës, të cilat si të tilla paraqesin lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

-me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale „Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 lidhur me nënpar.1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 41, 50,51,52 , 69, 70dhe 73 dhe nenit 185 par.1 lidhur me nënpar.1.4 dhe neni 31 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, :

GJYKON DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit:

1.J I i shqipton DËNIM ME GJOBË, në shumën katërqind (400) Euro, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet pas 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Këtë dënim me gjobë të shqiptuar i akuzuari mund ta paguajë me dy (2) këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues dhe jo më vonë se 3 muaj nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuari nuk e paguan këstin me kohë.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë nga një (1) ditë burgim.

2. P E i shqipton DËNIM ME GJOBË, në shumën katërqind (400) Euro, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet pas 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Këtë dënim me gjobë të shqiptuar i akuzuari mund ta paguajë me dy (2) këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues dhe jo më vonë se 3 muaj nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuari nuk e paguan këstin me kohë.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë nga një (1) ditë burgim.

1.Sh M i shqipton DËNIM ME GJOBË, në shumën katërqind (400) Euro, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet pas 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Këtë dënim me gjobë të shqiptuar i akuzuari mund ta paguajë me dy (2) këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues dhe jo më vonë se 3 muaj nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuari nuk e paguan këstin me kohë.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë nga një (1) ditë burgim.

II. Obligohen: Të pandehurit secili veq e veq, që në emër të paushallit gjyqësor ti paguajnë nga 10 (dhjetë) €, në emër të tarifës për kompensim të viktimave të krimit secili nga 20 (njëzetë) €, si dhe secili obligohet ti paguaj edhe shpenzimet për ekspertizë mjeko ligjore nga 15

(pesëmbëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Udhëzohet i dëmtuari A I nga fsh.LI K.M, që kërkeën pasuror juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale:

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm ka ngrit aktakuzë PP//II.nr.2761/2022 me dt.31.03.2023, kundër të akuzuarve: J I nga fshati D K.K, P E nga fshati G K.K si dhe Sh M nga fshati B K.K, të akuzuar për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nënpar.1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Me dt.me dt: 30.11.2024, Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar lidhur me këtë qështje juridiko-penale, në të cilën prezantuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Pejë, Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala si dhe të akuzuarit J I, P E dhe Sh M dhe palës së dëmtuar A I.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit të akuzuarve lidhur me fajsisë për veprën penale për të cilën akuzohen,

1. J I ka deklaruar se: e pranoj fajësin për veprën penale që i vihet në barrë, pendohem për veprën e kryer dhe premtan se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të vepra të ngjajshme penale.

2.P E ka deklaruar se: e pranoj fajësin për veprën penale që i vihet në barrë, pendohem për veprën e kryer dhe premtan se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të vepra të ngjajshme penale. Po ashtu më vjen keq për veprën e kryer i pandehuri i kërkon falje publike për veprën që të kam shkaktuar.

3.Sh M ka deklaruar se: e pranoj fajësin për veprën penale që i vihet në barrë, pendohem për veprën e kryer dhe premtan se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të vepra të ngjajshme penale.Po ashtu më vjen keq për veprën e kryer i pandehuri i kërkon falje publike për veprën që ta kam shkaktuar.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajsisë nga të akuzuarit ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurve, pasi ky pranim i fajsisë është bërë pa presion, me vullnet nga i pandehuri, i propozoi Gjykatës që të njëjtin ta shpalli fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit ndërsa si rrethanë lehtësuese ta merr pranimin e fajsisë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajsisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajsinë nga të akuzuarit;

1. J I, ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprën penale që i vihet në barrë, pendohet për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale

2. P E J I, ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprën penale që i vihet në barrë, pendohet për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, i kërkon falje publike pals së dëmtuar.

3. ShM, J I, ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprën penale që i vihet në barrë, pendohet për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, i pandehuri i kërkon falje publike të dëmtuarit në seancë.

I dëmtuari A I ka deklaruar që të pandehurit të dënohen sipas ligjit secili veq e veq, si dhe i njëjti bënë kërkesë pasurore juridike.

Gjykata ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 1 të KPPK-së.

Në këtë aspekt Gjykata, ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajsisë, ka vlerësuar se pranimi i fajsisë është bërë vullnetarisht nga tre të akuzuarit, se pranimi i fajsisë mbështetet në faktet e qështjës që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktkike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se të akuzuarit e lartëcekur, në bashkëkryerje kan kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nënpar.1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarit e lartëcekur, të i shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqense është vërtetuar se të njëjtit e kanë kryer veprën penale siq edhe vet e kanë pranuar sikurse në kohën, vëndin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën janë përgjegjës. Kjo për faktin se siq e kanë pranuar edhe vet, të akuzuarit në ditën kritike për të cilën akuzohen kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e cekura në aktakuzë.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve, J I, P Edhe Sh M, Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se të akuzuarit e kanë pranuar fajsinë në shqyrtimin fillestar, e që kjo është rrethanë e cila duke i ndërlidh me rrethanat tjera, si fakt se i njëjti është penduar për veprën e kryer penale, kanë kërku falje publike palëve të dëmtuar, të cilin e ka bashkëshort dhe kunat. Të njëjtit për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin. Ashtu që gjykatës i kanë premtuar se nuk do ta përsërisë më veprën penale.

Ndërsa, Gjykata si rrethanë rënduese gjeti dashjen direkte të kryerjes së veprës penale si dhe mënyrën e kryerjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

7. Sipas bindjës së gjykatës, dënim me gjobë i shqiptuar ndaj tre të pandehurve, në shumën katërqind (400) Euro, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet pas 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve të cilët në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nën. Par. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së..

Gjykata ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet.

Duke u bazuar në nenin 453 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, gjykata e ka obliguar në pagimin e paushallit gjyqësorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Konform dispozitave ligjore të nenit 463, të KPRK-së, u vendos për kërkesën pasurore juridike duke udhëzuar palën e dëmtuar që kompensimin e dëmit ta realizojnë në kontest të rregullt juridiko-civil.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 248 dhe nenit 364 dhe 370 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.54/2024 me datë.03.01.2025

Gjyqtarja Gjykuese

Sabrije Rraci

Bashkëpuntorja Profesionale

Fatmire Elezaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.